

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 20, datë 31.1.2024

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS  
PËR HARTIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE  
TË DREJTËSISË 2024-2030, TË PLANIT TË VEPRIMIT  
DHE TË PASAPORTËS SË TREGUESVE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, planit të saj të veprimit dhe pasaportës së treguesve.
2. Ministria e Drejtësisë, në rolin e institucionit udhëheqës për hartimin dhe monitorimin e politikave strategjike në fushën e drejtësisë, përgjigjet për mbarëvajtjen e procesit të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të dokumenteve të saj strategjike për vitet 2024-2030, si dhe për koordinimin e punës ndërmjet të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë, në kuadër të avancimit të reformës në drejtësi.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Drejtësisë dhe në përbërje të ketë anëtarë në nivel drejtues nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Brendshme;
- Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
- Departamenti i Administratës Publike;
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës;
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;
- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës;
- Drejtoria e Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror.

4. Në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës ftohen të marrin pjesë për të kontribuar ngushtësisht në hartimin e dokumentit strategjik me propozime konkrete për masa dhe aktivitete, në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë institucionale që burojnë nga ligjet të cilat rregullojnë veprimtaritë përkatëse, si dhe prioritetet e objektivat strategjike, përfaqësues nga institucionet e mëposhtme:

- Kuvendi;
- Gjykata Kushtetuese;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi;
- Kolegji i Posaçëm i Apelimit;
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
- Institucioni i Komisionerëve Publikë;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Gjykata e Lartë;
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Byroja Kombëtare e Hetimit;
- Prokuroria e Posaçme;
- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;

- Avokatura e Shtetit;
  - Avokati i Popullit;
  - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
  - Autoriteti i Medias Audiovizive;
  - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
  - Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë;
  - Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve;
  - Dhoma Kombëtare e Noterisë.
5. Me ftesë të kryetarit, në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës, në varësi të çështjeve që do të diskutohen dhe nëse çmohet e nevojshme, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues nga strukturat e varësisë së institucioneve qendrore, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare të fushave përkatëse, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile apo ekspertë të jashtëm, të cilët mund të japin kontributin e tyre në hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030.
6. Grupi ndërinstitucional i punës thirret nga kryetari, jo më pak se 2 (dy) herë në muaj. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjeve të radhës, pas konsultimit me anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës.
7. Grupi ndërinstitucional i punës ka këto përgjegjësi:
- a) Të bashkërendojë punën në nivel të lartë të politikës së Këshillit të Ministrave në kuadër të reformës në drejtësi;
  - b) Të bashkërendojë punën për përgatitjen e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, planit të veprimit dhe pasaportës së treguesve, në përputhje me:
    - udhëzimet e dhëna nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
    - vendimin nr.290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”, të ndryshuar;
    - Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030 (SKZHIE);
    - objektivat strategjike të programit buxhetor afatmesëm, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe burimet në dispozicion, të planifikuara për periudhën 2024-2030;
    - masat prioritare dhe institucionale sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”;


- gjetjet e raporteve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, miratur me vendimin nr.823, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave;
  - objektivat e programit të qeverisë shqiptare në lidhje me reformën në drejtësi dhe masat konkrete që do të ndërmarrin institucionet përgjegjëse për hartimin e një plani të përbashkët në realizimin e tyre;
- c) të shqyrtojë dhe të miratojë paraprakisht dokumentet përbërëse të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe dokumentet e saj strategjike;
  - ç) të dakordësojë Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe dokumentet e saj strategjike;
8. Në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës, kur vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e tij, marrin pjesë edhe përfaqësues së institucioneve, partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë, veprimtaria profesionale e të cilëve lidhet ngushtësisht me çështjet e sistemit të drejtësisë.
  9. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të informojë periodikisht Kryeministrin lidhur me mbarëvajtjen e procesit të punës, në zbatim të këtij urdhri.
  10. Grupi ndërinstitucional i punës, gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara në pikën 7, të këtij urdhri, mbështetet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e kryen Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë.
  11. Sekretariati teknik ka këto detyra:
    - a) Të sigurojë mbështetjen teknike për zhvillimin e takimeve e të proceseve të lidhura me funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës;
    - b) Të hartojë planin e detajuar të punës dhe të përcaktojë afatin kohor për përgatitjen e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe të dokumenteve të saj strategjike;
    - c) Të koordinojë punën ndërmjet institucioneve të përfaqësuara në grupin ndërinstitucional të punës, partnerëve për zhvillim, partnerëve socialë, si dhe aktorëve të tjerë të interesuar;
    - ç) Të sigurojë drejtimin metodologjik, teknik dhe standardizues të punës për anëtarët e grupit të punës për përgatitjen e instrumenteve përkatëse të planifikimit strategjik;
    - d) Të sigurojë përgatitjen dhe shpërndarjen e paketës së materialeve dhe agjendës përkatëse për mbledhjen e grupit ndërinstitucional të punës, minimalisht 5 (pesë) ditë përpara zhvillimit të takimit;

- dh) Të organizojë mbledhjet duke propozuar çështjet për diskutim, të përgatitura në bashkëpunim me anëtarë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm;
- e) Të përgatitë minutat e të gjitha takimeve, duke siguruar shpërndarjen pas miratimit nga kryesuesi i sekretariatit teknik;
- ë) Çdo detyrë tjetër të caktuar nga kryetari i grupit ndërinstitucional të punës.
12. Titullarët e institucioneve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij urdhri, të caktojnë përfaqësuesit e tyre dhe të njoftojnë zyrtarisht Ministrinë e Drejtësisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
13. Grupi ndërinstitucional i punës, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, të paraqesë në Këshillin e Ministrave, brenda muajit shtator 2024, për miratim Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe dokumentet e saj strategjike.
14. Shpenzimet financiare për aktivitetet e grupit ndërinstitucional të punës mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë dhe/ose financime nga donatorë.
15. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, grupi ndërinstitucional i punës dhe sekretariati teknik për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDIRAMA**

A large, stylized handwritten signature in black ink, consisting of a large loop on the left and several horizontal strokes extending to the right, crossing the printed name 'EDIRAMA'.

NR.PROT.478/1

DATE 1.2.2024

KUVENDIT  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRISË SË BRENDSHME  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME  
PARLAMENTIN  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR ADMINISTRATËN  
PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN  
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE  
SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS  
PUBLIKE  
AGJENCISË SHTETËRORE TË PROGRAMIMIT  
STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS  
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË  
CIVILE  
DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË  
PROVËS  
DREJTORISË SË PËRMBARIMIT  
GJYQËSOR SHTETËROR  
GJYKATËS KUSHTETUESE  
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR  
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË  
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI  
KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT  
KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT  
INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË  
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS  
GJYKATËS SË LARTË  
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME  
BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT  
PROKURORISË SË POSAÇME  
GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR  
INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE  
KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE  
AVOKATURËS SË SHTETIT  
AVOKATIT TË POPULLIT  
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË  
INFORMACIONIT  
AUTORITETIT TË MEDIAS AUDIOVIZIVE

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË  
DHOMËS KOMBËTARE TË NDËRMJETËSVE  
DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERISË

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

